



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**V E N D I M**

**Nr. 157, datë 15.08.2022**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 49, datë 01.03.2022, e z. R.Sh., ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, aftësisë së kufizuar<sup>2</sup> dhe për çdo shkak tjetër, nga ana Bashkisë Fier. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, përgjatë viteve 2015-e në vijim, z. R.Sh. ka qenë i pastrehë. Për shkak të situatës së tij emergjente për strehim, Bashkia Fier e ka strehuar përkohësisht<sup>4</sup> në ambientin “Njësi Shërbimi” nr. 7, Godina GI +2, me sipërfaqe 38.6 m<sup>2</sup>.

Ankesa e z. R.Sh. ka të bëjë me çështjen e pagesës së energjisë elektrike dhe shërbimit të furnizimit me ujë, përgjatë periudhës kohore janar 2015 – e në vijim, periudhë kohore, kjo kur ai nuk ka patur kontratë shërbimi me OSHEE sh.a. dhe UK sh.a. Fier, për të paguar energjinë elektrike dhe ujin e banesës, ku ishte caktuar për të banuar provizorisht. Ai pretendon se përgjatë kësaj periudhe kohore, duke mos qenë pronar i banesës, duke mos patur një kontratë

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD;

<sup>2</sup> Referuar kopjes së Dëshmisë nr. 2954, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Shqipërisë;

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

<sup>4</sup> Sipas informacionit të administruar nga Zyra Rajonale Fier e KMD-së, nëpërmjet Vendimit nr. 3, datë 31.01.2022, të Këshillit Bashkiak Fier është miratuar kërkesa për strehim definitiv të familjes së z. R.Sh., në banesën e sipërcituar.

të rregullt shërbimi me OSHEE sh.a. dhe UK sh.a., Fier, si dhe në kushtet e pamundësisë ekonomike, është debitor me dy shoqëritë e sipërcituara, të cilat ia kanë ndërprerë shërbimet përkatëse prej 7 vitesh.

Ai sqaron se detyrimi për të kryer pagesën e shërbimit për energjinë elektrike dhe atë të ujit, për këtë periudhë kohore, është i Bashkisë Fier. Ndërkohë që, ky institucion, nuk i ka kryer asnjëherë këto pagesa, duke rritur debinë ndaj shoqërisë OSHEE sh.a. dhe UK sh.a. Fier, pasi janë shtuar edhe vlerat e kamatëvonesave përkatëse. Si rrjedhim, familja e ankuesit prej një periudhe 7 vjeçare jeton në mungesë të shërbimit me energji elektrike dhe me ujë të pijshëm.

Z. R.Sh. sqaron se ndodhet në gjendje tepër të rëndë ekonomike dhe në pamundësi për të shlyer vetë debinë ndaj OSHEE sh.a. Njëkohësisht, ai shprehet se është me aftësi të kufizuara dhe shkalla e invaliditetit të tij është e plotë. Ankuesi sqaron se nuk është përfitues i ndihmës ekonomike dhe as i ndonjë ndihme tjetër financiare nga ana e Bashkisë Fier. Përveç sa më sipër, ankuesi shprehet se është njoftuar në takim pranë Bashkisë Fier, ku i është komunikuar se debinë ndaj shoqërive të sipërcituara duhet ta kryejë vetë, duke lidhur kontratë shërbimi me to. Ky fakt kundërshtohet nga z. R.Sh., i cili nuk ka mundësi financiare.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të

Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “*diskriminimi*” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme.

Ligji nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Sipas nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar, përcaktohet se: “*1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.*”

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, gërmat “a” e “b” të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”*

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 49, datë 01.03.2022, e z. R.Sh., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>5</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Fier dhe për dijeni OSHEE sh.a., Fier, UK sh.a. Fier dhe ankuesit, me shkresën nr. 392/1 Prot., datë 04.03.2022.

Në prapësimet e Bashkisë Fier, KMD kërkoi që të përfshihej informacioni mbi çështjet e mëposhtme, si dhe të dërgoheshin aktet e poshtëcituar:

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e ankuesit;**

---

<sup>5</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: *“Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

2. Informacion lidhur me arsyet, përse familja e ankuesit jeton prej 7 vitesh pa energji elektrike/shërbim furnizimi me ujë;
3. Informacion, nëse debia e krijuar ndaj shoqërisë OSHEE sh.a., Fier/UK sh.a. Fier, përgjatë periudhës kohore 2015 – e në vijim, që ankuesi ka jetuar provizorisht në banesë sociale, është detyrim i Bashkisë Fier;
4. Informacion lidhur me masat që do të merren nga Bashkia Fier, lidhur me zgjidhjen e kësaj çështjeje;
5. Informacion nëse ankuesi R.Sh. ka aplikuar për të përfituar ndihmë ekonomike pranë Bashkisë Fier. Nëse po, të jepen të dhënat përkatëse lidhur me vitet kur ka aplikuar dhe nëse ka qenë përfitues i kësaj ndihme;
6. Informacion nëse ankuesi ka qenë përfitues i ndihmave të tjera, financiare nga ana e Bashkisë Fier;
7. Informacion mbi mënyrën se si po procedohet për zbatimin e Vendimit nr. 3, datë 31.01.2022, të Këshillit Bashkiak Fier, nëpërmjet së cilit është miratuar kërkesa për strehim definitiv të familjes së z. R.Sh..
8. Informacion nëse ankuesit i është kthyer përgjigje nga Bashkia Fier, lidhur me kërkesën e tij të datës 04.11.2021. Nëse po, të dërgohet kopje e shkresës zyrtare të Bashkisë Fier, që është dërguar në adresë të z. R.Sh..
9. Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen në shqyrtim.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, nëpërmjet shkresës së sipërcituar, KMD kërkoi informacion nga OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Fier dhe UK sh.a., Fier, lidhur me çështjet e mëposhtëme:

1. Informacion nëse ankuesi Romeo Llazar R.Sh., i datëlindjes 10.07.1964, banues në Fier, ka patur përgjatë periudhës 2005 e në vijim, kontratë shërbimi të nënshkruar me OSHEE sh.a., Fier/UK sh.a. Fier. Nëse po, të dërgohen kopje të kontratave përkatëse;
  2. Nëse ankuesi nuk ka lidhur kontrata shërbimi për energjinë elektrike/shërbimin e furnizimit me ujë, me OSHEE sh.a./UK sh.a., Fier, cili është subjekti debitor për energjinë elektrike/ shërbimin e furnizimit me ujë, të ambientit “Njësi shërbimi” nr. 7, Godina GI +2, me sipërfaqe 38.6 m<sup>2</sup>, Fier, përgjatë periudhës 2015 e në vijim;
  3. Informacion mbi datën e saktë, kur banesës, ku jetonte provizorisht familja e ankuesit R.Sh., i është ndërprerë energjia elektrike/shërbimi i furnizimit me ujë;
  4. Çdo informacion tjetër që ka lidhje me çështjen në shqyrtim;
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar së KMD-së, OSSH sh.a., Fier, dërgoi shkresën nr. 392/2, datë 23.03.2022, nëpërmjet së cilës sqaron se në sistemin e OSSH sh.a. rezultojnë se z. R.Sh. nuk ka kontratë të lidhur me OSSH sh.a. Fier. Referuar verifikimit të kryer nga grupi i punës, kontrata FI1A2102711303362 në emër të Bashkisë Fier furnizon objektin në të cilën jeton abonenti dhe aktualisht rezultojnë me debi 340.96 lekë. Ndërprerja e

energjisë elektrike është kryer në datën 15.01.2019 për arsye debie. Në datën 18.02.2022, pasi është shlyer detyrimi, objektit i është rilidhur energjia elektrike. Bashkëlidhur shkresës së OSSH sh.a. Fier janë dërguar aktet Ekstrakt Debie për kontratën FI1A2102711303362-Bashkia Fier dhe procesverbali i ndërprerjes dhe rilidhjes së energjisë elektrike.

- Në përgjigje të shkresës nr. 392/1 Prot., datë 04.03.2022 së KMD-së, Bashkia Fier dërgoi shkresën nr. 392/3, datë 30.03.2022, nëpërmjet së cilës informon se ky institucion, në cilësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, gëzon kompetenca ligjore dhe ushtron funksione administrativo-ligjore, pa dallim gjinie, race, feje, etnie, identiteti gjinor, bindjeje politike etj.

Ofrimi i shërbimeve të administratës publike nga ana e nëpunësve përkatës është i bazuar tërësisht në ligj, aktet normative të respektimit të të drejtave të qytetarëve për përfitimin e çdo shërbimi publik, si dhe parimeve ligjore të sanksionuara të funksionimit të administratës.

Për shkak të situatës emergjente për strehim, z. R.Sh. është strehuar përkohësisht në ambientin “njësi shërbimi” nr. 7, Godina G1+2, sip. 38.6 m<sup>2</sup>, dhe ka jetuar prej muajit dhjetor 2014 e në vijim. Fillimisht pagesat e energjisë elektrike dhe ujit janë kryer nga Bashkia Fier me qëllimin e ndihmesës së qytetarit deri në krijimin e mundësive më të favorshme për strehim, si dhe deri në lidhjen e kontratës tip të huapërdorjes, e cila do t’i mundësonte këtij qytetari strehimin pa kundërshtpërblim, por me detyrimin për të përballuar shpenzimet e rrjedhura nga kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Nisur nga fakti që ambienti në të cilin është strehuar përkohësisht është njësi shërbimi edhe tarifat e energjisë elektrike dhe ujit janë njësi shërbimi. Nënshkrimi i kontratës së hua përdorjes me Bashkinë Fier do të bënte të mundur kalimin e kontratave të shërbimit në kontratë abonent familjarë, duke ulur kështu edhe vlerën e faturimit përkatës. Në mënyrë të përsëritur, Zyra e Administrimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira ka kontaktuar dhe komunikuar me qytetarin ku i është shpjeguar sa më sipër por qytetari vazhdimisht ka refuzuar. Në kushtet kur, ka qenë e pamundur të arrihet në një marrëveshje me këtë qytetar për të zgjidhur ngërçin e krijuar, si dhe për t’i ofruar atij një strehim më të përshtatshëm, me Vendimin të Këshillit të Bashkisë nr. 22, datë 25.02.2020, është miratuar si familje përfituese për t’u trajtuar me programin social të strehimit “Subvencionim i qirasë në tregun e lirë” si dhe vlera përkatëse e subvencionimit, program të cilin e refuzoi.

Së dyti, Bashkia Fier ka likujduar të gjitha detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat e krijuara si pasojë e debisë së akumuluar nga ky qytetar dhe me vendimin e Këshillit bashkiak Fier nr. 3, datë 31.01.2022, ka miratuar kërkesën e qytetarit për vijimin e qëndrimit të tij në po të njëjtin ambient shërbimi pa kundërshtpërblim. Qytetari detyrohet të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe UKF.

Qytetari vazhdon të refuzojë nënshkrimin e kontratës me Bashkinë Fier, e cila vë në dukje të KMD-së se në zbatim të legjislacionit në fuqi, lidhja e kontratës është një element/kriter detyrues ligjor, të cilit ky institucion nuk mund t'i shmanget.

Në lidhje me aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, Bashkia Fier sqaron se kuadri ligjor që rregullon kriteret për përfitimin dhe trajtimin me ndihmë ekonomike, nuk i lejon shtetasve që gëzojnë statusin e invalidit të punës, të aplikojë për ndihmë ekonomike, pasi janë tashmë duke përfituar ndihmë ekonomike në formën e pagesës së invaliditetit. Pavarësisht kësaj, ankuesi ka qenë vazhdimisht përfitues i ndihmave të tjera dhe jo vetëm financiare, por edhe ushqimore dhe paketave higjeno-sanitare.

Duke qenë se ky shtetas ndodhet në kushte të vështira financiare dhe sociale, Bashkia Fier sqaron se e ka trajtuar me prioritet dhe në mënyrë të përsëritur i janë ofruar mundësi të ndryshme për të përmirësuar sadopak situatën e tij, në bashkëpunim edhe me shoqatat e ndryshme, ku midis të tjerave edhe me Kishën Katolike, e cila i ofroi mundësi punësimi, të cilat z. R.Sh. i ka refuzuar.

Bashkia Fier dhe strukturat e saj përgjegjëse janë plotësisht të angazhuara dhe të predispozuar për t'i mundësuar të gjithë qytetarëve /banorë të juridiksionit të saj territorial, të gjithë ndihmën dhe asistencën e nevojshme në garantimin e të drejtës themelore të strehimit të përshtatshëm dhe të përballueshëm, konform dispozitave në fuqi.

- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar të KMD-së, OSSH sh.a. Fier informon se në sistemin e kësaj shoqërie rezulton se z. R.Sh. nuk ka kontratë të lidhur me OSSH. Referuar verifikimit të kryer nga grupi i punës, kontrata FI1A210271303362 në emër të bashkisë Fier furnizon objektin në të cilën jeton abonenti dhe aktualisht rezulton me debi 340.96 lekë. Ndërprerja e energjisë elektrike është kryer në datë 15.11.2019 për arsye debie. Në datën 18.02.2022 pasi është shlyer detyrimi, objektit i është rilidhur energjia elektrike. Bashkëlidhur shkresës në fjalë, OSSH sh.a. ka dërguar ekstratin e debisë për kontratën FI1A210271303362 të Bashkisë Fier dhe procesverbali i ndërprerjes dhe i rilidhjes së energjisë elektrike.
- Në vijim të shkresave të sipërcituara, strukturat përgjegjëse të KMD-së kontaktuan me Zyrën Rajonale Fier të KMD-së, nga ku kërkuan verifikimin e fakteve të cituara në shkresat e Bashkisë Fier dhe OSSH sh.a. Fier, si dhe u kërkua të kontaktohej me ankuesin për të vërtetuar nëse problematikat e parashtruara në ankesë ishin zgjidhur. Specialistja e Zyrës Rajonale Fier konfirmoi sa më sipër, duke theksuar faktin se Bashkia Fier ka shlyer të gjitha detyrimet apo debitë e ankuesit për energji elektrike dhe ujë të pijshëm, shërbime të cilat janë rilidhur, ndërkohë që ankuesi R.Sh. refuzon të nënshkruajë kontratën e huapërdorjes me këtë institucion, për banesën që i është dhënë me vendim të Këshillit Bashkiak Fier. Vetëm në vijim të nënshkrimit të kësaj kontrate, ankuesi do të mund të lidhë kontratë shërbimi në emër të tij me OSSH sh.a. dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a. Fier.

- Me e-mailin e datës 05.06.2022, Zyra Rajonale Fier e KMD-së njoftoi se ankuesi pretendonte se nuk ka energji elektrike. Sipas tij faturistët në bashkëpunim me administratoren e pallatit ulin siguresën për të ndaluar energjinë elektrike në banesën e tij. Ankuesi kërkonte zhvillimin e një seance dëgjimore mbi ankesën e tij.
- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në kërkesën e ankuesit R.Sh., të përcjellë me e-mail nëpërmjet specialistes se Zyrës Rajonale Fier të KMD-së, ku shprehet se ende nuk ka energji elektrike në banesën e tij, Komisioneri vendosi realizimin e seancës dëgjimore në datën 30.05.2022, ora 11:00. Palët u njoftuan nëpërmjet shkresës nr. 392/4 Prot., datë 09.05.2022, së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesja e Bashkisë Fier, përfaqësuesi i OSHEE sh.a., Drejtoria Rajonale Fier dhe ankuesi R.Sh..

Fillimisht, ankuesi parashtrroi pretendimet e tij ndaj Bashkisë Fier dhe OSHEE sh.a., Fier, të cilat në vijim u lexuan edhe nga përfaqësuesi i KMD-së në seancë dëgjimore.

Përfaqësuesja e Bashkisë Fier sqaroi se ankuesi ishte pajisur me banesë me Vendim të Këshillit Bashkiak Fier, por ai nuk pranonte të nënshkruante kontratën e huapërdorjes pa shpërbllim me Bashkinë Fier. Njëkohësisht përfaqësuesja e Bashkisë Fier sqaroi se në kushtet kur ankuesi përfitonte pagesë për aftësi të kufizuar, nuk mund të ishte njëkohësisht edhe përfitues i ndihmës ekonomike. Pavarësisht kësaj, ajo sqaroi për të pranishmit në seancë dëgjimore se ankuesi është ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Bashkisë Berat me veshje dhe ushqime, si dhe ishte asistuar për të gjetur punësim, të cilin ai nuk e kishte pranuar. Ajo sqaroi gjithashtu se Bashkia Fier kishte paguar edhe debitë e ankuesit për energji elektrike dhe ujë dhe depozitoi në cilësi prove në seancë kopje të faturave përkatëse për shlyerje debie. Përfaqësuesi i OSHEE sh.a., Fier pohoi gjithashtu se Bashkia Fier kishte paguar debinë e ankuesit për energjinë elektrike në datën 18.02.2022 dhe ankuesit i ishte lidhur energjia elektrike në banesën e tij.

I pyetur për sa më sipër, ankuesi u shpreh se energjia elektrike mund t'i ishte lidhur, por ai nuk i hapte çelësat e dritës në banesën e tij, pasi s'donte të shpenzonte energji dhe në vijim do të duhet të paguante faturat përkatëse.

Përfaqësuesit e KMD-së i rekomanduan ankuesit që të lidhte kontratën e huamarrjes me Bashkinë Fier, si dhe në vijim të nënshkruante kontratat përkatëse me OSHEE sh.a. Fier.

- Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Bashkisë Fier dërgoi pranë KMD-së e-mailin e datës 08.06.2022, ku informon se: *“ Në vijim të ballafaqimit të zhvilluar pranë zyrës suaj më datë 30.05.2022, si dhe detyrave të lëna nga ana juaj, ju lutem gjeni bashkëlidhur kopje të skanuar të Kontratës Tip të Huapërdorjes për shtetasin R.Sh.. Ky shtetas vijon të refuzojë*

*nënshkrimin e kontratës. Bashkia Fier ka likujduar të gjitha detyrimet e rrjedhura nga kontratat e OSHEE sh.a., Fier dhe UKF sh.a., sipas vlerave respektive të faturave, kopje të të cilave j'ua kemi vënë në dispozicion në takimin e zhvilluar. ”*

- Me e-mailin e datës 13.06.2022, KMD kontaktoi sërish me Zyrën Rajonale të tij në Fier, ku kërkoi verifikimin e çështjes në fjalë.
- Me e-mailin e datës 14.06.2022, Zyra Rajonale Fier e KMD-së dërgoi informacion se kishte kontaktuar me administratoren e banesave sociale, pranë Bashkisë Fier, e cila kishte pohuar faktet e sipërcituara, duke mos dhënë asnjë shpjegim lidhur me arsyet përse z. R.Sh. nuk nënshkruan kontratën e huapërdorjes pa shpërbllim me Bashkinë Fier, lidhur me banesën që i është dhënë me vendim të Këshillit Bashkiak. Në vijim, Zyra Rajonale Fier sqaron KMD-në se nga ankuesi tashmë kërkohet pajisja me kangjella, për të rrethuar banesën e tij për të cilën ka depozituar edhe kërkesë në Bashkinë Fier dhe jo pretendimet e parashtruara në ankesë pranë KMD-së.

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.**

Legjislacioni shqiptar ka rregulluar ligjërisht çështjen e mbështetjes dhe krijimit të mundësive për strehim të familjeve që janë në nevojë. Në këtë kontekst, ligji nr. 22/2018 *“Për strehimin social”* ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Sipas nenit 3/3 të ligjit të sipërcituar, strehimi i familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërit prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.

Në nenin 4, të ligjit nr. 22/2018 *“Për strehimin social”* parashikohet se:

*“1.Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.*

*2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:*

*a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;*

*b) shërbime bazë, brenda mjedisit të banimit;*  
*c) qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;*  
*ç) qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;*  
*d) akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare;*  
*dh) qasje të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe fëmijët, duke lehtësuar shkallën e plotësimit të nevojave të veçanta të banimit për ta.*  
*3. Strehimi nuk duhet të çojë drejt veçimit të një grupi përfituesish nga grupet e tjera”.*  
 Ligji i sipërcituar përcakton edhe llojin e programeve sociale të strehimit. Sipas nenit 11 të këtij ligji, përcaktohet se:

*“1. Në programet sociale të strehimit përfshihen:*

- a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;*
  - b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;*
  - c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;*
  - ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;*
  - d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;*
  - dh) programi i banesave të specializuara.*
- 2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.*  
*3. Individ/familja nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë.”*

Në referencë të nenit 13 të ligjit të sipërcituar, statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave; b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat: i) i fatkeqësive natyrore; ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë; iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve; iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë; c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj. Parashikimet e sipërcituara, të këtij neni, zbatohen vetëm për ato individë/familje që

kanë të ardhura të pamjaftueshme, ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji.

Në nenin 14, pikat 1-2, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” parashikohet se:

*“1. Përfshirja në programet sociale të strehimit bëhet nëpërmjet aplikimit në zyrën përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore të vendbanimit/ vendqëndrimit të aplikantit.*  
*2. Individit/familja pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta ose të ulëta, që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë.”*

Në bazë nenit 3, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet se:  
*“Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.”*

Neni 4 i këtij ligji parashikon gjithashtu se: *“1. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore. 2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të vetëqeverisjes vendore respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore. 3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë persona juridikë publikë. 4. Çdo bashki dhe qark është njësi vetë-qeverisëse me vazhdimësi”.*

Lidhur me objektin e ankesës së z. R.Sh., KMD ka konstatuar se ajo konsiston në 3 (tre) momente kryesore:

1. Sigurimi i një banese të përhershme, nëpërmjet programeve të strehimit social;
2. Shlyerja e debive të akumuluar të ankuesit ndaj shoqërive OSHEE sh.a. dhe Ujësjetës Kanalizime sh.a., Fier dhe rilidhja e shërbimeve përkatëse;
3. Përfitimi i ndihmës ekonomike;

**1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit, për mos sigurimin e një banese të përhershme, nëpërmjet programeve të strehimit social, nga ana e Bashkisë Fier.**

Referuar shpjegimeve të dhëna nga ankuesi lidhur me pretendimin e tij për mos sigurim strehimi permanent nga ana e Bashkisë Fier është sqaruar se përgjatë viteve 2014-e në vijim, ai ka qenë i pastrehë. Për shkak të situatës së tij emergjente për strehim, prej këtij viti e në vijim, Bashkia Fier e ka strehuar përkohësisht në ambientin “Njësi Shërbimi” nr. 7, Godina GI +2, me sipërfaqe 38.6 m<sup>2</sup>. Në bazë të Vendimit nr. 22, datë 25.02.2020, të Këshillit Bashkiak Fier, ku është kryer miratimi i listës emërore të familjeve të pastreha që përfitojnë nga programi social i subvencionit të qirasë në tregun e lirë dhe të masës së subvencionit të kësaj qiraje, z. R.Sh. është pjesë e kësaj liste. Në vijim të miratimit të këtij vendimi, ai ka refuzuar të jetë pjesë e këtij programi.

Për sa më sipër, Zyra Rajonale Fier e KMD-së ka vënë në dijeni Komisionerin, menjëherë pas depozitimit të ankesës, se çështja në fjalë rezulton e zgjidhur, pasi me Vendimin nr. 3, datë 31.01.2022, të Këshillit Bashkiak Fier, *“Për miratimin e kërkesës së familjes/individit të pastrehë e në nevojë të R.Sh., për strehim në banesat sociale me qira të Bashkisë Fier, si dhe të kërkesës së familjes së znj. M.M., e strehuar në banesat sociale, për ndihmë në faljen e detyrimeve të prapambetura”*<sup>6</sup> është miratuar kërkesa e z. R.Sh., në cilësinë e individit në nevojë për strehim, për vijimin e strehimit të tij në ambientin Njësi Shërbimi, nr. 7, Godina GI+2, me sipërfaqe 38.6 m<sup>2</sup>, pa kundërshtim.

Në nenin 33, pika 4, gërma b) të LMD, të ndryshuar, parashikohet se *“Ankesa nuk pranohet kur.... ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.”* Në rastin konkret, KMD gjykon që pretendimi konkret, pjesë e ankesës nr. 49, datë 01.03.2022, së z. R.Sh., nuk mund të pranohet për shqyrtim, pasi është zgjidhur nga Bashkia Fier, e cila ka marrë masat e nevojshme, duke e strehuar definitivisht ankuesin nëpërmjet programit të banesave sociale me qira, para depozitimit të kësaj ankese. Në këtë kontekst, KMD gjykon se pretendimi në fjalë nuk mund të pranohet, pasi është haptazi i pabazuar.

---

<sup>6</sup> Rezulton se ankuesi R.Sh. ka marrë dijeni me vonesë, në vijim të depozitimit të ankesës, mbi miratimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Fier.

## **2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit për mosshlyerjen e debive të akumuluar ndaj OSHEE sh.a. dhe UKF sh.a., nga ana e Bashkisë Fier.**

Për sa më sipër, rezulton se për shkak të situatës emergjente për strehim, ankuesi është strehuar përkohësisht nga ana e Bashkisë Fier, në ambientin “njësi shërbimi” nr. 7, Godina G1+2, sip. 38.6 m<sup>2</sup>, ku ai ka jetuar prej muajit dhjetor 2014 e në vijim.

Fillimisht pagesat e energjisë elektrike dhe ujit janë kryer nga Bashkia Fier me qëllimin e ndihmesës së qytetarit, deri në krijimin e mundësive më të favorshme për strehim permanent të tij. Kontratat e shërbimit për banesën e sipërcituar kanë qenë në emër të Bashkisë Fier, e cila ka shlyer në mënyrë periodike pagesat e shërbimeve përkatëse. Në vijim, Ky institucion e ka ndërprerë pagesën e shërbimeve të sipërcituara, pasi ankuesi e kishte kaluar limitin mujor të pagesës për energji elektrike dhe ujë. Ndërprerja e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. Fier, është kryer në datë 15.11.2019, për arsye debie. Në datën 18.02.2022 pasi është shlyer detyrimi nga ana e Bashkisë Fier, objektit i është rilidhur energjia elektrike.

Në Vendimin nr. 3, datë 31.01.2022, e Këshillit Bashkiak Fier, *“Për miratimin e kërkesës së familjes/individit të pastrehë e në nevojë të R.Sh., për strehim në banesat sociale me qira të Bashkisë Fier, si dhe të kërkesës së familjes së znj. M.M., e strehuar në banesat sociale, për ndihmë në faljen e detyrimeve të prapambetura”* përcaktohet se individ i tashmë që është strehuar definitivisht, duhet të paguajë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe Ujesjellës Kanalizime sh.a. Fier.

Hapi i parë në vijim të miratimit të vendimit të sipërcituar konsiston në lidhjen e kontratës tip të huapërdorjes, pa shpërblim me Bashkinë Fier, e cila do t’i mundësonte këtij qytetari strehimin pa kundërshtpërblim, por me detyrimin për të përballuar shpenzimet e rrjedhura nga kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Për sa më sipër, ankuesi refuzon të nënshkruajë një kontratë të tillë, duke shmangur njëkohësisht edhe lidhjen e kontratave të shërbimit në emër të tij, me OSHEE sh.a. dhe UKF sh.a. Nënshkrimi i kontratës së huapërdorjes me Bashkinë Fier do të bënte të mundur kalimin e kontratave të shërbimit në kontratë abonent familjarë, duke ulur kështu edhe vlerën e faturimit përkatës, por ankuesi refuzon nënshkrimin e saj, pavarësisht sugjerimit të KMD-së dhe kërkesave të vazhdueshme nga ana e Bashkisë Fier.

Në kushtet kur, Bashkia Fier ka shlyer debitë e ankuesit për energji elektrike dhe ujë deri në momentin e miratimit të Vendimit nr. 3, datë 31.01.2022, të Këshillit Bashkiak Fier, KMD gjykon se tashmë ankuesi duhet të zbatojë detyrimin ligjor për lidhjen e kontratës së huapërdorjes pa shpërblim, si dhe lidhjen e kontratave të shërbimit me shoqëritë e sipërcituara.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Fier. Në këto kushte, nuk mund të ekzistojë diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

### **3. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit për mosdhënien e ndihmës ekonomike nga ana e Bashkisë Fier.**

Referuar Dëshmisë nr. 2954, të lëshuar nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, rezulton se në bazë të Vendimit të KMCAP Fier, ankuesi R.Sh. është invalid pune i plotë prej datës 30.04.2021 deri në datën 01.05.2022. Në këto kushte, ai është përfitues i pagesës si individ me aftësi të kufizuara. Ankuesi kërkon të jetë edhe përfitues i ndihmës ekonomike, duke pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes së tij ekonomike nga ana e Bashkisë Fier.

Nga informacioni i përcjellë nga Bashkia Fier rezulton se ai nuk ka aplikuar për ndihmë ekonomike duke plotësuar formularin aplikimi për Ndihmë Ekonomike, pasi i është sqaruar se në bazë të legjislacionit përkatës, ai nuk mund të jetë përfitues i ndihmës ekonomike, ndërkohë që përfiton pagesë për aftësi të kufizuara.

Në pikën 7, të ligjit nr. 57/2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”* parashikohet se:

*“Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:*

- a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;*
- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;*
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;*
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;*
- d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.”*

Në pikën 6, të nenit 12 të ligji nr. 57/2019 *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”* parashikohet se: *“Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve në nenin 7, të këtij ligji, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.”*

Ankuesi jeton i vetëm, pa patur persona të tjerë në familje. Në bazë të dispozitave të sipërcituara ai nuk mund të jetë njëkohësisht përfitues i ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësi të kufizuar. Por, pavarësisht kësaj, z. R.Sh. ka qenë vazhdimisht përfitues i ndihmave të tjera dhe jo vetëm financiare, por edhe ushqimore dhe paketave higjeno-sanitare nga ana e Bashkisë Fier. Në këtë kontekst, mbështetur në parashikimet e dispozitave të sipërcituara, KMD gjykon se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë disfavorizues e të pabarabartë nga ana e Bashkisë Fier.

Në këto kushte, nuk mund të ekzistojë diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pikat 1 dhe 3, nenit 20, pika 1, nenit 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-12, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së z. R.Sh., lidhur me pretendimin e mos strehimit të tij, permanent, nëpërmjet programeve të strehimit social të Bashkisë Fier.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit të z. R.Sh., për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Fier.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha – Shërbime  
Shkak- gjendja ekonomike, aftësi e kufizuar, cdo shkak tjetër  
Lloji i vendimit – mospranim dhe mosdiskriminim